



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 74 Prot.

Tiranë, më 17.1.2025

URDHËR

Nr.17, datë 17.1.2025

**PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR MBI ZBATIMIN E
LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË
PROCEDURAT E PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV, LËVIZJES
PARALELE, NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË KATEGORINË E
LARTË DREJTUESE NË SHËRBIMIN CIVIL, TË PLANIFIKUARA PËR T’U
ZHVILLUAR NGA BASHKIA TIRANË GJATË VITIT 2025**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 82 prot., 938 datë 20.12.2024, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2025”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjes dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Ndër të tjera, në planin vjetor është parashikuar edhe zhvillimi i mbikëqyrjes, përcaktuar në nenin 14 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në Bashkinë Tiranë, gjatë vitit 2025.

Për këtë arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 106, datë 15.12.2023, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2025”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyrë zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Bashkia Tiranë, gjatë vitit 2025,

URDHËROJ:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesi të rekrutimit, të planifikuar për t'u zhvilluar nga Bashkia Tiranë, gjatë vitit 2025.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

1. Altin Shumeli	Drejtor i Mbikëqyrjes (Drejtues grupi)
2. Behare Hoxha	Inspektore (Anëtar)
3. Françeska Doksani	Inspektore (Anëtar)
4. Dorela Halilaj	Inspektore (Anëtar)
5. Ina Skënderi	Specialiste IT (Anëtar)
3. Metodologjia që do të ndiqet është e përcaktuar në programin e mbikëqyrjes së miratuar nga Komisioneri.
4. Me përfundimin e afatit të mbikëqyrjes, do të përgatitet relacioni dhe raporti përkatës, ku do të pasqyrohet informacioni i administruar dhe propozimet përkatëse për mënyrën e ndjekjes së problemeve të evidentuara.
5. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në këtë institucion.
6. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Bashkia Tiranë.
7. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë vendim.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT**

Nr. 74/1 Prot.

Tiranë, më 17.1.2025

**MIRATOHET
KOMISIONERI**

Pranvera Strakosha

PROGRAM MBIKËQYRJE E ORIENTUAR

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Bashkia Tiranë**
- 2. Objekti i mbikëqyrjes:** Mbikëqyrje e orientuar mbi zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në procedurat e planifikuara për pranimin në nivelin ekzekutiv, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin në kategorinë e lartë drejtuese në shërbimin civil që do të zhvillohet nga Bashkia Tiranë përgjatë vitit 2025.
- 3. Baza ligjore:** Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Rregullorja “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar;

VKM nr. 118, datë 5.3.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND- së”, (i ndryshuar);

VKM nr. 242, datë 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, (i ndryshuar);

VKM nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, (i ndryshuar);

Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i DAP, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

4. Periudha e mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të përfshijë mbledhjen e informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurremeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Bashkia Tiranë, gjatë vitit 2025, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes së grupit të punës në fazat e testimit, në disa prej procedurave të përzgjedhura sipas tipologjisë së pozicioneve, fushës së arsimit apo numrit të pozicioneve vakante.

5. Afati i mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të fillojë në datë 01.01.2025 dhe do të përfundojë brenda datës 31.12.2025.

6. Procedura që do të ndiqet:

Mbikëqyrja e orientuar do të kryhet nëpërmjet mbledhjes së të dhënave nga grupi i punës, i cili do të marrë pjesë në fazën e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në disa prej procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, për të gjitha nivelet e nëpunësisë.

Për dokumentimin e procesit të mbikëqyrjes do të kqyren të gjitha aktet e publikuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, duke i pasqyruar të dhënat

e nxjerra nga këto akte, në formë tabelare (excel) me qëllim përpunimin e tyre.

Me përzgjedhje, grupi i punës i ngarkuar me këtë proces, do të ndjekë disa nga procedurat e konkurrencës, duke e evidentuar këtë proces përmes kopjeve të akteve të hartuara gjatë zhvillimit të fazave të procedurës së konkurrencës, si dhe procesverbalin e kqyrjes të mbajtur nga grupi i punës për këtë qëllim.

Me përfundimin e afatit të mbikëqyrjes, do të përgatitet relacioni dhe raporti përkatës, ku do të pasqyrohet informacioni i administruar dhe propozimet përkatëse për mënyrën e ndjekjes së problemeve të evidentuara.

7. Grupi i punës:	1. Altin Shumeli	Drejtor i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
	2. Behare Hoxha	Inspektore (Anëtar)
	3. Françeska Doksani	Inspektore (Anëtar)
	4. Dorela Halilaj	Inspektore (Anëtar)
	5. Ina Skënderi	Specialiste IT (Anëtar)

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2025.
2. Pranimi dhe lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive, respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 23 dhe 25, të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të këtyre procedurave.
3. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil.
4. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
5. Emërimet në shërbimin civil sipas procedurës së aplikuar:
 - lista e fituesve të konkurrimeve 2024;

- lista e fituesve të konkurrimeve të mëparshme;
- në zbatim të vendimeve gjyqësore;
- nga transferimet e përkohshme në përfundim të pezullimit.

6. Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.

Në vijim të programit të mbikëqyrjes, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për të përfunduar këtë proces.

1. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo pranimit nga jashtë shërbimit civil, për disa procedura konkurrimi të përzgjedhura për verifikim, nga grupi i punës:
 - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivel ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë - nivel i ulët ose i mesëm drejtues/ nivel i lartë drejtues*).
 - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*);
 - Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve;
 - Aktet që materializojnë përbërjen e organeve të KPP/KPND/KKP .
 - Pranimi/lëvizje paralele nivel ekzekutiv;
 - Lëvizje paralele/ngritje në detyrë/pranim nga jashtë në nivelin e mesëm dhe të ulët drejtues;
 - *Akte të nxjerra nga institucioni në zbatim të nenit 32, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese;*
 - Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
 - Ankimimi;
 - Etj.
2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arbana BASHA